

**AKTI I THEMELIT  
I SHOQËRISË ANONIME ME OFERTË PRIVATE**

**“55 INVEST” SH.A**

Themeluesit që nënshkruajnë më poshtë:

**1. ARKONSTUDIO sh.p.k**, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 19.08.2014, me NUIS L42019004I, e cila sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të datës 06.06.2018, përfaqësohet nga z. Krenar DILA, i datëlindjes 07.08.1985 identifikuar me kartën e identitetit me nr I 50807046 K madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**2. SHPËTIM LIÇAJ** datëlindje 25.09.1959 që është i identifikuar me kartën e identitetit nr F 90225237 E madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**3. “CANAJ” sh.p.k** regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 16.06.1994, me NUIS K27730701R, e cila sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të datës 06.06.2018 përfaqësohet nga z. Besmir Selgjakaj, i datëlindjes 21.05.1985 identifikuar me kartën e identitetit me nr I 50521055B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**4. EDJON HILA** dt lindje 09.01.1988, që është i identifikuar me kartën e identitetit nr I80109078Q madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

duke u bazuar në Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Aktin e Themelimit, vendosën të miratojnë statutin e shoqërisë tregtare me ofertë private “**55 INVEST sh.a**”, si më poshtë vijon:


**Kreu I**

**OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

**Neni 1.** Objekti i veprimtarisë.

1. Shoqëria tregtare “**55 INVEST**” SH.A ka si objekt të veprimtarisë së saj:

**Investime dhe shërbime në fushën e turizmit dhe imobiliare,etj.**



2. Objekti i aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

## **Neni 2.** Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Asambleja e Aksionareve vendosi që shoqërinë ta emërtojë: **"55 INVEST"** SH.A

2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Njesia 7 Rruga Frosina Plaku Pall 21 shkalla A ,apartamenti 5 .

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

## **Neni 3.** Regjimi juridik

3.1. Shoqëria është shoqëri aksionare. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të saj, Asambleja e Përgjithshme mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të përshtasë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4 . Të drejtat e Shoqërisë dhe të Aksionarëve**

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka te drejte të marrë pjesë si ortakë/akisonare në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Me fitimin e personalitetit juridik Shoqëria bëhet përgjegjëse kundrejt palëve të treta për detyrimet dhe dëmet që shkakton gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

Aksionarët e shoqërisë do të jenë përgjegjës kundrejt palëve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin aksionar.

4.5. Aksionaret kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4.6. Aksionaret kanë të drejtë të marrin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5. Kohëzgjatja**

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Statutit të Shoqërisë.

### **Kreu III**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

6.1. Shoqëria tregtare "**55 INVEST**" sh.a do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 64.000.000. (gjashtëdhjetë e katë milion) Lekë, e cila zotërohet tërësisht nga aksionarët.

6.2. Pjesëmarrja e aksionarëve vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

**A. ARKONSTUDIO** sh.p.k regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 19.08.2014, me NUIS L42019004I zotëron 1.600 aksione, me vlere 16.000.000 (gjashtëmbëdhjetë milion)Lekë nga ku vlera e secilit aksion është në shumën 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe që në përqindje i korrespondon 25 % (njetzetë e pesë përqind) të aksioneve.

**B) SHPËTIM LIÇAJ** dt lindje 25.09.1959 që është i indentifikuar me kartën e identitetit nr F 90225237 E zotëron 1.600 aksione, me vlere 16.000.000 (gjashtëmbëdhjetë milion)Lekë nga ku vlere e secilit aksion është në shumën 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe që në përqindje i korrenspondon 25 % (njetetë e pesë përqind) të aksioneve..

**C) CANAJ** sh.p.k regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datë 16.06.1994, me NUIS K27730701R, zotëron 1.600 aksione, me vlere 16.000.000 (gjashtëmbëdhjetë milion)Lekë nga ku vlere e secilit aksion është në shumën 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe që në përqindje i korrenspondon 25 % (njetetë e pesë përqind) të aksioneve.

**D) EDJON HILA**, date lindje 09.01.1988 i identifikuar me kartën e identitetit nr I 80109078 Q zotëron 1.600 aksione, me vlere 16.000.000 (gjashtëmbëdhjetë milion)Lekë nga ku vlere e secilit aksion është në shumën 10.000 (dhjetëmijë) lekë dhe që në përqindje i korrenspondon 25 % (njetetë e pesë përqind) të aksioneve..

6.3. Kapitali është i ndarë në 6.400 (gjashtëmijë e katërqind) aksione të zakonshme me vlere nominale 10.000 (dhjetmije) Leke secili.

#### Kreu IV

### ORGANET E SHOQËRISË

#### Neni 7

7.1. Vendimet në Shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Këto vendime shënohen ne regjistrin përkatës. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur që administratori i parë i shoqërisë të jetë z. **Përparim Kadiu** madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. me një mandat 3 (tre) vjeçar.

7.3 Anëtarët të Këshillit të Mbikëqyrës emërohen:

- 1.Ardit Liçaj
- 2.Nasjel Çiço
- 3.Alfred Hila

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Z. **Ardit LIÇAJ** emërohet Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, detyrë të cilën do ta ushtrojë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të tij si anëtar.



4

## Kreu V

### ADMINISTRIMI

#### Neni 8

8.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

## Kreu VI

### DISPOZITA TË TJERA

#### Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet aksionarëve të shoqërisë në përputhje me pjesët e tyre takuese.

9.3. Aksionaret bien dakord që për 3 vite ushtrimore radhazi pas krijimit dhe regjistrimit të shoqërisë nuk do të shpërndajnë fitime apo dividende dhe fitimet e shoqërisë do të kalojnë shoqërisë vetë për investime.

9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset në 6 (gjashtë) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

### AKSIONARËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE "55 INVEST" SHA

- ARKONSTUDIO sh.p.k. përfaqësuar nga Krenar DILA
- Shpëtim LIÇAJ
- "CANAJ" sh.p.k përfaqësuar nga z. Besmir Selgjakaj
- Edjon HILA 